

PROTOKOLL SHITESË 6 PËR TREGTINË NË SHËRBIME

PËR MARRËVESHJEN MBI NDRYSHIMIN DHE PRANIMIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Preambula

Palët në Marrëveshjen për Ndryshimin dhe Pranimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore" (këtu e tutje referuar si "Palët")

Duke pasur parasysh Preambulën, objektivat e përcaktuara në nenin 1 dhe Kapitullin VI (nenet 26 deri 29) të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 2006 (CEFTA 2006) në lidhje me tregtinë në shërbime, përfshirë tregtinë elektronike, Palët gradualisht do të arrijnë një liberalizim progresiv të tregjeve të tyre të shërbimeve në përputhje me nenin V të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (MPTSH) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT);

Duke pranuar se liberalizimi i mallrave dhe shërbimeve në kuadër të CEFTA 2006 do të shërbej si një rrugë për arritjen e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe rritjes në rajon duke zgjeruar investimet brenda rajonit dhe mundësitë e prodhimit;

Duke synuar të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë midis Palëve dhe për promovimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në shërbime;

Duke pasur parasysh se sektori i shërbimeve luan një rol në rritje në ekonomitë dhe tregtinë e palëve, me potencial të madh për të rritur tregtinë ndër-rajonale të shërbimeve në një mënyrë reciprokisht të dobishme;

Asnjë dispozitë e këtij Protokollit nuk mund të interpretohet se përjashton Palët nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse sipas marrëveshjeve të tyre ndërkombëtare, duke përfshirë marrëveshjet ekzistuese tregtare rajonale dhe dypalëshe dhe Marrëveshjen e OBT-së;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 ***Përkufizimet***

1. Për qëllimet e këtij Protokollit:

- (a) "masë" nënkupton çdo masë nga një Palë, qoftë në formën e një ligji, rregulloreje, rregulle, procedure, vendimi, veprimi administrativ ose ndonjë formë tjetër;
- (b) "ofrimi i një shërbimi" përfshin prodhimin, shpërndarjen, marketingun, shitjen dhe shpërndarjen e një shërbimi;

- (c) "masat nga Palët që ndikojnë në tregtinë në shërbime" përfshin masat lidhur me:
- (i) blerjen, pagesën ose përdorimin e një shërbimi;
 - (ii) qasjen dhe përdorimin, lidhur me ofrimin e një shërbimi, shërbimeve që kërkohen nga këto Palë t'i ofrohen publikut në përgjithësi;
 - (iii) praninë, duke përfshirë praninë komerciale, të personave të një Pale për ofrimin e një shërbimi në territorin e një Pale tjetër;
- (d) "prania komerciale" nënkupton çdo lloj ndërmarrje biznesore ose profesionale, duke përfshirë përmes:
- (i) themelimit, blerjes¹ ose mbajtjes së një personi juridik, ose
 - (ii) krijimit ose mbajtjes së një dege ose një zyre përfaqësimi,
- brenda territorit të një Pale me qëllim të ofrimit të një shërbimi;
- (e) "sektori" i një shërbimi nënkupton:
- (i) duke iu referuar një zotimi specifik, një ose më shumë, ose të gjithë nënsektorët e atij shërbimi, siç përcaktohet në Planin e një Pale,
 - (ii) ndryshe, tërësinë e atyre sektorëve të shërbimeve, përfshirë të gjithë nënsektorët e saj;
- (f) "shërbimi i një Pale tjetër" nënkupton një shërbim që është ofruar:
- (i) nga ose në territorin e asaj Pale tjetër, ose në rastin e transportit detar, nga një anije e regjistruar në bazë të ligjeve të kësaj Pale tjetër ose nga një person i asaj Pale tjetër që ofron shërbimin nëpërmjet operimit të një anijeje dhe/ose përdorimi i saj në tërësi ose pjesërisht; ose
 - (ii) në rastin e ofrimit të një shërbimi nëpërmjet pranisë komerciale ose nëpërmjet pranisë së personave fizikë, nga një ofrues shërbimesh i asaj Pale tjetër;
- (g) "ofrues shërbimi" nënkupton çdo person fizik ose juridik që ofron një shërbim;²

¹ Shprehja "blerje" kuptohet si përfshirje e pjesës së kapitalit në një person juridik me qëllim të krijimit ose mbajtjes së lidhjeve të qëndrueshme ekonomike.

² Kur shërbimi nuk jepet drejtpërdrejt nga personi juridik, por nëpërmjet formave tjera të pranisë komerciale, siç është një degë ose zyrë përfaqësimi, ofruesit të shërbimeve (p.sh. personi juridik), megjithatë, përmes kësaj pranie do t'i akordohet trajtimi i ofruar për ofruesit e shërbimit sipas këtij

- (h) "ofrues monopol i një shërbimi" nënkupton çdo person, publik ose privat, i cili në tregun përkatës të territorit të një Pale është i autorizuar ose i përcaktuar zyrtarisht ose në fuqi nga kjo Palë si ofruesi i vetëm i atij shërbimi;
- (i) "konsumator shërbimi" nënkupton çdo person që pranon ose përdor një shërbim;
- (j) "person" nënkupton një person fizik ose një person juridik;
- (k) "person fizik" nënkupton një shtetas të një Pale sipas legjislacionit të saj të brendshëm;
- (l) "person fizik i një Pale tjetër" nënkupton një person fizik i cili banon në territorin e asaj Pale tjetër ose çfarëdo Pale tjetër dhe i cili sipas ligjit të asaj Pale tjetër: (i) është shtetas i asaj Pale tjetër; ose (ii) ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në atë Palë tjetër.
- (m) "person juridik" nënkupton çdo entitet juridik të themeluar ose ndryshe organizuar sipas ligjit në fuqi, qoftë për përfitim apo ndryshe, dhe qoftë në pronësi private apo qeveritare, duke përfshirë çdo shoqëri, besim, partneritet, sipërmarrje të përbashkët, pronësi të vetme ose shoqatë;
- (n) "person juridik i një Pale" nënkupton:
një person juridik të themeluar në përputhje me ligjet e një Pale dhe që ka zyrën e regjistruar, administratën qendrore ose selinë e biznesit në territorin e asaj Pale. Nëse personi juridik ka vetëm zyrën e tij të regjistruar ose administratën qendrore në territorin e një Pale, nuk do të konsiderohet si person juridik i asaj Pale, përveç nëse ai/ajo angazhohet në veprimtari thelbësore të biznesit në atë Palë;
një person juridik:
 - (i) është "në pronësi" nga personat e një Pale nëse më shumë se 50 për qind e interesit të ekuitetit në të është në pronësi të personave të asaj Pale;
 - (ii) "kontrollohet" nga personat e një Pale nëse këta persona kanë fuqi të emërojnë shumicën e drejtorëve të tyre ose përndryshe të drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë ligjore;
 - (iii) "bashkohet" me një person tjetër kur kontrollon ose kontrollohet nga personi tjetër; ose kur ai/ajo dhe personi tjetër kontrollohen nga i njëjti person;
- (o) "filial" i një personi juridik të një Pale nënkupton një person juridik i cili në mënyrë efektive kontrollohet nga një person tjetër juridik i asaj Pale;

Protokoll. Një trajtim i tillë duhet të shtrihet në praninë përmes të cilës ofrohet shërbimi dhe nuk duhet të shtrihet në ndonjë pjesë tjetër të ofruesit që ndodhet jashtë territorit ku shërbimi është ofruar.

- (p) "degë" e një personi juridik të një Pale nënkupton një vend biznesi që nuk ka personalitet juridik i cili duket i përhershëm, siç është zgjerimi i një trupi amë, menaxhohet dhe është i pajisur materialisht për të negociuar për biznes me palët e treta në mënyrë që këto të fundit, edhe pse në dijeni se, nëse ka nevojë, do të kenë një lidhje ligjore me trupin amë, zyra qendrore e të cilës është jashtë vendit, të mos merren drejtpërdrejt me këtë trup amë por të mund të kryejnë biznes në vendin e biznesit që përbën zgjerimin;
- (q) "taksat e drejtpërdrejta" përfshijnë të gjitha taksat mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin total ose mbi elementët e të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë taksat mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës, taksat mbi pronat, trashëgimet dhe dhuratat, dhe taksat mbi shumat totale të mëditjeve ose pagat e paguara nga ndërmarrjet, si dhe taksat mbi vlerësimin e kapitalit;
- (r) "Orari" nënkupton një orar të referuar në nenin 18 dhe që gjendet në Shtojcën III;
- (s) "Zotim specifik" nënkupton një zotim specifik të përcaktuar në Orarin e referuar në nenin 18;
- (t) "Shërbime të riparimit dhe mirëmbajtjes së avionëve" nënkuptojnë ato aktivitete që ndërmerren në një avion ose një pjesë të tij kur ai tërhiqet nga shërbimi dhe nuk përfshijnë të ashtuquajturën mirëmbajtje të linjës;
- (u) "Shitja dhe tregtimi i shërbimeve të transportit ajror" nënkupton mundësitë për transportuesin ajror në fjalë për të shitur dhe tregtuar lirisht shërbimet e transportit ajror duke përfshirë të gjitha aspektet e marketingut, siç janë: hulumtimi i tregut, reklamimi dhe shpërndarja; këto aktivitete nuk përfshijnë çmimet e shërbimeve të transportit ajror as kushtet e aplikueshme;
- (v) "Shërbime të sistemit kompjuterik të rezervimit (CRS)" nënkupton shërbimet e ofruara nga sistemet kompjuterike që përmbajnë informata mbi oraret e transportuesve ajrore, disponueshmërinë, çmimet dhe rregullat e çmimeve, nëpërmjet të cilave mund të bëhen rezervime ose mund të lëshohen bileta;
- (w) "Të drejtat e trafikut" nënkupton të drejtën për shërbime të planifikuara dhe jo të planifikuara për të operuar dhe/ose për të transportuar udhëtarë, ngarkesa dhe postë me kompensim ose për të marrë me qira, brenda ose mbi territorin e një Pale, përfshirë pikat që do të shërbehen, rrugët që do të operohen, llojet e trafikut që do të barten, kapacitetin që do të ofrohet, tarifat që do të ngarkohen dhe kushtet e tyre, dhe kriteret për përcaktimin e linjave ajrore, duke përfshirë kriteret e tilla si numri, pronësia dhe kontrolli.

Neni 2
Fushëveprimi dhe Mbulimi

1. Ky Protokoll zbatohet për masat e miratuara ose të shfrytëzuara nga Palët që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve. Ai zbatohet për të gjithë sektorët e shërbimeve, përveç siç tregohet në paragrafin 4.

2. Për qëllimet e këtij Protokollit, tregtia e shërbimeve përcaktohet si ofrimi i një shërbimi:

- (a) nga territori i një Pale në territorin e një Pale tjetër;
- (b) në territorin e një Pale të konsumatorit të shërbimit të një Pale tjetër;
- (c) nga një ofruar shërbimesh të një Pale, nëpërmjet pranisë tregtare në territorin e çdo Pale tjetër;
- (d) nga një ofruar shërbimi i një Pale, nëpërmjet pranisë së personave fizikë të një Pale në territorin e një Pale tjetër.

3. Për qëllimet e këtij Protokollit:

(a) "Masat nga Palët" nënkupton masat e ndërmarra nga:

- (i) qeveritë dhe autoritetet qendrore, rajonale ose lokale; dhe
- (ii) organet joqeveritare në ushtrimin e kompetencave të deleguara nga qeveritë ose autoritetet qendrore, rajonale ose lokale;

Në përmbushjen e detyrimeve dhe zotimeve të veta sipas Protokollit, secila Palë ndërmerr masa të tilla të arsyeshme që mund të jenë në dispozicion për të siguruar respektimin e tyre nga qeveritë rajonale dhe lokale dhe autoritetet dhe organet joqeveritare brenda territorit të saj;

- (b) "shërbimet" përfshijnë çdo shërbim në çdo sektor përveç shërbimeve të ofruara në ushtrimin e autoritetit qeveritar;
- (c) "shërbim i ofruar në ushtrimin e autoritetit qeveritar" nënkupton çdo shërbim që nuk ofrohet as në baza komerciale, as në konkurrencë me një ose më shumë ofruar të shërbimeve.

4. Në lidhje me shërbimet e transportit ajror, ky Protokoll nuk zbatohet për masat që prekin të drejtat e trafikut ajror ose për masat që prekin shërbimet që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e të drejtave të trafikut ajror. Ky Protokoll zbatohet për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së avionëve, shitjen dhe tregtimin e shërbimeve të transportit ajror dhe të sistemit kompjuterik të rezervimit (CRS).

5. Ky Protokoll nuk zbatohet për ligjet, rregulloret ose kërkesat që rregullojnë prokurimin nga agjencitë qeveritare të shërbimeve të blera për qëllime qeveritare dhe jo që kanë për qëllim rishitjen komerciale ose përdorimin në ofrimin e shërbimeve për shitje komerciale.

6. Ky Protokoll nuk zbatohet për asnjë subvencion ose grant të siguruar nga një Palë, përfshirë huat e mbështetura nga qeveria, garancitë dhe sigurimet.

Neni 3 *Trajtimi i kombit më të favorizuar*

1. Pa paragjykuar masat e ndërmarra në përputhje me nenin II: 2 të MPTSH, secila Palë jep menjëherë dhe pa kushte, sa i përket të gjitha masave që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve, shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të çdo Pale tjetër trajtim jo më pak të favorshëm se trajtimin të cilin e jep për shërbimet e ngjashme dhe ofruesit e shërbimeve të çdo subjekti jo-palë.
2. Trajtimi i dhënë për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve sipas marrëveshjeve të tjera ekzistuese ose të ardhshme të lidhura nga njëra nga Palët dhe të njoftuara sipas nenit V ose nenit V bis të MPTSH nuk është subjekt i paragrafit 1.
3. Nëse një Palë ndryshon ose nënshkruan një marrëveshje të llojit të përmendur në paragrafin 2, ajo do të njoftojë palët e tjera pa vonesë. Me kërkesë të ndonjë Pale tjetër, Pala ndryshuese negocion përfshirjen në këtë Protokoll të trajtimit jo më pak të favorshëm sesa ai i dhënë, për shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve sipas marrëveshjes me subjektin jo-palë.
4. Ky nen nuk interpretohet që të parandalojë ndonjë Palë të japë ose ofrojë përparësi për vendet fqinje në mënyrë që të lehtësojë shkëmbimet e kufizuara në zonat kufitare të afërta të shërbimeve që prodhohen dhe konsumohen në nivel lokal.

Neni 4 *Qasja në treg*

1. Sa i përket qasjes në treg përmes mënyrave të ofrimit të identifikuar në nenin 2, secila Palë u ofron shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të çdo pale tjetër trajtim jo më pak të favorshëm se ai i parashikuar sipas kushteve, kufizimeve dhe kushteve të rëna dakord dhe të specifikuara në planin e saj.
2. Në sektorët ku ndërmerren zotime për qasje në treg, masat që një Palë nuk ruan ose miraton qoftë në bazë të një nëndivizioni rajonal ose në bazë të gjithë territorit të saj, përveçse kur specifikohet ndryshe në Planin e saj, përkufizohen si:
 - (a) kufizime në numrin e ofruesve të shërbimeve, qoftë në formë të kuotave numerike, monopoleve, ofruesve ekskluzivë të shërbimeve ose kërkesave të një testi të nevojave ekonomike;
 - (b) kufizime në vlerën totale të transaksioneve të shërbimeve ose asete në formën e kuotave numerike ose kërkesa për një test të nevojave ekonomike;
 - (c) kufizime në numrin e përgjithshëm të operacioneve të shërbimit ose në sasinë totale të shërbimit të shprehur në terma të njësisive numerike të përcaktuara në formën e kuotave ose kërkesës për një test të nevojave ekonomike;³

³ Nën-paragrafi 2 (c) nuk përfshin masat e një Pale që kufizojnë inputet për ofrimin e shërbimeve.

- (d) kufizime në numrin e përgjithshëm të personave fizikë që mund të punësohen në një sektor të caktuar të shërbimeve ose që një ofrues shërbimesh mund të punësojë dhe që janë të nevojshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me ofrimin e një shërbimi të veçantë në formën e kuotave numerike ose kërkesës së një testi të nevojave ekonomike;
 - (e) masa të cilat kufizojnë ose kërkojnë lloje të veçanta të personave juridikë ose sipërmarrjeve të përbashkëta përmes të cilave një ofrues shërbimesh mund të ofrojë një shërbim; dhe
 - (f) kufizime në pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në kufijtë maksimal të përqindjes në aksionet e huaja ose në vlerën totale të investimeve të huaja individuale ose agregate.
3. Asnjë Palë nuk fut në territorin e saj asnjë kufizim të ri për ofrimin e shërbimeve, siç përcaktohet në nenin 2, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Protokoll.

Neni 5 ***Trajtimi Kombëtar***

1. Në sektorët e dhënë në planin e saj, dhe në varësi të kushteve dhe kualifikimeve të përcaktuara aty, secila palë u jep shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të çdo pale tjetër, në kuptim të të gjitha masave që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve, trajtim jo më pak të favorshëm se që u jep shërbimeve të ngjashme vendore dhe ofruesve të shërbimeve.⁴
2. Një Palë mund të përmbushë kërkesat e paragrafit 1 sipas shërbimeve dhe ofruesve të shërbimeve të çdo Pale tjetër, qoftë trajtim formalisht identik ose trajtim formalisht të ndryshëm nga ai që u jep shërbimeve të ngjashme vendore dhe ofruesve të shërbimeve.
3. Trajtimi formalisht identik ose formalisht i ndryshëm konsiderohet si më pak i favorshëm nëse modifikon kushtet e konkurrencës në favor të shërbimeve ose ofruesve të shërbimeve të Palës në krahasim me shërbimet ose ofruesit e shërbimeve të një pale tjetër.

Neni 6 ***Orari i zotimeve specifike***

1. Secila Palë përcakton në një Orar të konsoliduar zotimet specifike që ajo ndërmerr sipas këtij Protokoll. Në lidhje me sektorët ku zotimet e tilla ndërmerren, Orari specifikon:

(a) termat, kufizimet dhe kushtet për qasje në treg;

⁴ Detyrimet specifike të marra sipas këtij neni nuk interpretohen që të kërkojnë nga cilado Palë të kompensojë ndonjë mangësi të natyrshme konkurruese që rezulton nga karakteri i huaj i shërbimeve përkatëse ose ofruesve të shërbimeve.

- (b) kushtet dhe kualifikimet për trajtimin kombëtar;
- (c) ku është e përshtatshme, kornizën kohore për zbatimin e zotimeve të tilla; dhe
- (d) kur është e përshtatshme, datën e hyrjes në fuqi të këtyre zotimeve.

2. Orari i zotimeve specifike të palëve paraqitet në Shtojcën III dhe është pjesë përbërëse e këtij Protokolli.

Neni 7 ***Modifikimi i Orareve***

Palët, pas kërkesës me shkrim të një Pale të njoftuar në Nën-komitetin e Tregtisë së Shërbimeve, mbajnë konsultime për të shqyrtuar çdo kërkesë për modifikim të një zotimi specifik në zotimet specifike të Palës kërkuese. Konsultimet mbahen brenda tre muajve pasi pala kërkuese të ketë njoftuar kërkesën e saj në Nën-komitetin për Tregti në Shërbime. Në konsultime, Palët synojnë të mbajnë një nivel të përgjithshëm të zotimeve reciprokisht të favorshme jo më pak të favorshme për tregtinë se që parashikohet në Orarin e zotimeve specifike para konsultimeve të tilla. Çdo modifikim i zotimeve specifike është subjekt i procedurave të përcaktuara në nenet 47 të CEFTA 2006.

Neni 8 ***Lëvizja e personave fizikë***

1. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me lëvizjen e personave fizikë që ofrojnë shërbime në një Palë qeverisen nga Shtojca I e këtij Protokolli. Personat fizikë të mbuluar nga një zotim specifik i një Pale lejohen të ofrojnë shërbimin në atë Palë në përputhje me kushtet e këtij zotimi.

2. Ky protokoll nuk zbatohet për masat të cilat prekin personat fizikë që kërkojnë qasje në tregun e punës të një Pale, e as nuk zbatohet për masat në lidhje me shtetësinë, qëndrimin ose punësimin e përhershëm.

3. Asgjë në këtë protokoll nuk i pengon Palët të zbatojnë masa për ta rregulluar hyrjen ose qëndrimin e përkohshëm të personave fizikë në territorin e tyre, duke përfshirë edhe masat e nevojshme për të mbrojtur integritetin e personave fizikë dhe për të siguruar lëvizjen e rregullt të këtyre personave përgjatë kufijve të tyre, me kusht që masat e tilla të mos zbatohen në atë mënyrë që t'i anulojnë ose t'i dëmtojnë përfitimet që rrjedhin nga cilado Palë sipas kushteve të një zotimi specifik.

Neni 9 ***Transparenca***

1. Secila Palë boton menjëherë dhe, përveç në raste të situatave emergjente, më së voni deri në momentin e hyrjes së tyre në fuqi, të gjitha masat përkatëse të aplikimit të përgjithshëm që

kanë të bëjnë me ose ndikojnë në funksionimin e këtij Protokollit. Gjithashtu publikohen edhe marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ose ndikojnë në tregtinë e shërbimeve në të cilat një Palë është nënshkruese.

2. Kur publikimi i referuar në paragrafin 1 nuk është praktik, ky informacion vihet në dispozicion të publikut në mënyra tjera.
3. Secila palë krijon një pikë kontakti për shërbimet e parapara në nenin 44 të CEFTA 2006.
4. Secila Palë informon menjëherë dhe së paku një herë në vit Nën-komitetin e Tregtisë së Shërbimeve lidhur me futjen ose ndryshimin e ligjeve rregulloreve ose udhëzimeve administrative ekzistuese të cilat ndikojnë dukshëm në tregtinë e shërbimeve të mbuluara nga angazhimet e saj specifike sipas këtij Protokollit.
5. Secila Palë, për aq sa është e mundur, siguron paraprakisht informacionin lidhur me çdo masë relevante të aplikimit të përgjithshëm që Pala propozon të miratojë në mënyrë që t'u japë Palëve të tjera mundësinë për të komentuar mbi masën. Informacioni u ofrohet Palëve të tjera nëpërmjet Nën-komitetit të Tregtisë së Shërbimeve dhe Pikat e Kontaktit të Shërbimeve shërbejnë si mjete për komunikime të tilla.
6. Secila Palë mund të njoftoj Nën-komitetin e Tregtisë së Shërbimeve lidhur me çfarëdo mase nga cilado Palë tjetër, të cilën ajo e konsideron se ka ndikim në funksionimin e këtij Protokollit.

Neni 10 ***Rregullimi i Brendshëm***

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit, Palët, për të përmbushur objektivat legjitime të politikave, mbajnë të drejtën e rregullimit dhe miratimit të rregulloreve të reja.
2. Në sektorët ku ndërmerren angazhime specifike, secila Palë siguron që të gjitha masat e zbatimit të përgjithshëm që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve administrohen në mënyrë të arsyeshme, objektive dhe të paanshme.
3. (a) Secila Palë, sa më parë që është e mundur, mban ose themelon tribunale ose procedura praktike gjyqësore, arbitrare ose administrative të cilat, me kërkesë të një ofruesi të prekur shërbimesh, për shqyrtimin e menjëhershëm të, dhe kur arsyetohet, ofrojnë mjete të përshtatshme për vendimet administrative që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve. Kur procedurat e tilla nuk janë të pavarura nga agjencia e ngarkuar me vendimin administrativ të përfshirë, Pala siguron që procedurat sigurojnë një rishikim objektiv dhe të paanshëm.

(b) Dispozitat e nën-paragrafit (a) nuk interpretohen në atë mënyrë që të kërkojnë nga një Palë që të themelojë tribunale ose procedura të tilla nëse kjo nuk do të ishte në kundërshtim me strukturën e saj kushtetuese ose natyrën e sistemit të saj juridik.

4. Kur kërkohet autorizimi për ofrimin e një shërbimi për të cilin është bërë një zotim specifik, autoritetet kompetente të një Pale, brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas paraqitjes së një kërkesë të konsideruar të plotë sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme, informojnë aplikuesin lidhur me vendimin mbi kërkesën. Me kërkesë të aplikuesit, autoritetet kompetente të Palës sigurojnë, pa vonesa të panevojshme, informacion në lidhje me statusin e aplikimit.

5. Me qëllim të sigurimit se masat e lidhura me kërkesat dhe procedurat e kualifikimit, standardet teknike si dhe kërkesat dhe procedurat e licencimit nuk përbëjnë pengesa të panevojshme për tregtinë e shërbimeve, Nën-komiteti i Tregtisë së Shërbimeve mundet që, nëpërmjet organeve përkatëse të cilat i krijon, të zhvillojë disiplina të nevojshme. Disiplina të tilla synojnë të sigurojnë që kërkesat e tilla, ndër të tjera:

- (a) bazohen në kritere objektive dhe transparente, siç janë kompetenca dhe aftësia për të ofruar shërbimin;
- (b) nuk janë më të rënda se sa është e nevojshme për të siguruar cilësinë e shërbimit;
- (c) në rast të procedurave licencuese, të mos përfshijnë në vetvete kufizim për ofrimin e shërbimit.

6. (a) Në sektorët në të cilët një Palë ka ndërmarrë angazhime specifike, në pritje të hyrjes në fuqi të disiplinave të zhvilluara në këto sektorë sipas paragrafit 5, Pala nuk zbaton kërkesat e licencimit dhe kualifikimit dhe standardet teknike që anulojnë ose dëmtojnë angazhimet e saj specifike në një mënyrë që:

- (i) nuk përputhet me kriteret e përshkruara në nën paragrafët 5 (a), (b) ose (c); dhe
- (ii) nuk mund të pritej në mënyrë të arsyeshme nga ajo Palë në kohën kur ajo bëri angazhimet specifike në ato sektore.

(b) Me rastin e përcaktimit se a është një Palë në përputhje me detyrimin sipas paragrafit (a), atëherë merren parasysh standardet ndërkombëtare të organizatave relevante ndërkombëtare⁵ të aplikuara nga ajo Palë.

7. Në sektorët ku ndërmerren angazhime specifike në lidhje me shërbimet profesionale, secila Palë parasheh procedura të përshtatshme për të verifikuar kompetencën e profesionistëve të çdo Pale tjetër.

8. Palët shqyrtojnë çështjet e rregullimit të brendshëm brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokollit. Me kërkesë të një ose më shumë Palëve, Palët do të hyjnë në negociata për

⁵ Termi "organizata relevante ndërkombëtare" i referohen organeve ndërkombëtare, anëtarësia e të cilave është e hapur për organet përkatëse të të paktën të gjithë anëtarëve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).

disiplinat e rregullimit të brendshëm që do të përfshihen në këtë Protokoll si Shtojcë ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 11 ***Njohja***

1. Për qëllimet e përmbushjes së standardeve ose kritereve përkatëse për autorizimin, licencimin ose certifikimin e ofruesit të shërbimeve, secila palë i kushton vëmendje të duhur çdo kërkesë nga një Palë tjetër për njohje të arsimit ose përvojës së fituar, kërkesave të përmbushura, ose licencave ose certifikatave të dhëna në atë Palë tjetër. Njohja e tillë mund të bazohet në një marrëveshje ose aranzhim me atë Palë tjetër, ose të akordohet në mënyrë autonome.

2. Kur një Palë, me anë të marrëveshjes ose aranzhimit, njih arsimin ose eksperiencën e fituar, kërkesat e përmbushura, ose licencat apo certifikatat e dhëna, në territorin e një shteti që nuk është Palë, atëherë ajo Palë i jep mundësi adekuate Palëve të tjera për të negociuar pranimin e tyre në një marrëveshje apo aranzhim të tillë qofshin ato ekzistente apo që do të bëhen në të ardhmen, ose për të negociuar një marrëveshje apo aranzhim të krahasueshëm me të. Kur një Palë pranon njohjen në mënyrë autonome, atëherë ajo ofron mundësi të përshtatshme për çdo Palë tjetër për të demonstruar se arsimi ose përvoja e fituar, kërkesat e përmbushura, ose licencat apo certifikatat e dhëna në territorin e asaj Palë tjetër duhet të njihen gjithashtu.

3. Një Palë nuk jep njohje në atë që e njëjta do të përbënte diskriminim midis Palëve në zbatimin e standardeve ose kritereve të saj për autorizimin, licencimin ose certifikimin e ofruesve të shërbimeve ose kufizim të maskuar në tregtinë e shërbimeve.

4. Palët, pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, kryejnë proceset e nevojshme për të zhvilluar marrëveshje ose aranzhime të njohjes reciproke për profesionet e rregulluara.

Neni 12 ***Monopolet dhe Ofruesit Ekskluzivë të Shërbimeve***

1. Secila Palë siguron që çdo ofrues monopol i një shërbimi në territorin e tij, në ofrimin e shërbimit të monopolit në tregun përkatës, nuk vepron në atë mënyrë që paraqet jo-përputhshmëri me detyrimet e Palës në përputhje me nenin 4 dhe zotimet e tij specifike.

2. Kur ofruesi monopol i një Palë garon, direkt ose nëpërmjet një kompanie të lidhur, në ofrimin e një shërbimi jashtë fushëveprimit të të drejtave të tij monopole dhe që i nënshtrohet angazhimeve specifike të asaj Palë, atëherë Pala siguron që një ofrues i tillë nuk abuzon pozitën e tij për të vepruar në territorin e saj në një mënyrë që nuk përputhet me këto angazhime.

3. Nën-komiteti i Tregtisë së Shërbimeve mundet që, me kërkesë të një Palë që ka arsye të besojë se një ofrues monopol i një shërbimi të ndonjë Palë tjetër vepron në kundërshtim me paragrafin 1 ose 2, të kërkojë nga Pala që themelon, mirëmban ose autorizon ofruesin e tillë, të ofrojë informacione specifike në lidhje me operacionet përkatëse.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen gjithashtu për rastet e ofruesve ekskluzivë të shërbimeve, ku një Palë, formalisht ose në efekt, (a) autorizon ose krijon një numër të vogël të ofruesve të shërbimeve dhe (b) parandalon ndjeshëm konkurrencën ndërmjet atyre ofruesve në territorin e saj.

Neni 13 ***Praktikat Biznesore***

1. Palët kuptojnë që praktikatat e caktuara biznesore të ofruesve të shërbimeve, përveç atyre që bien në nenin 12, mund të kufizojnë konkurrencën dhe në këtë mënyrë të kufizojnë tregtinë e shërbimeve.

2. Secila Palë, me kërkesën e secilës Palë tjetër, hyn në konsultime me qëllim të eliminimit të praktikave të përmendura në paragrafin 1. Pala e adresuar do të shqyrtoj në mënyrë të plotë dhe të kujdesshme kërkesën e tillë dhe bashkëpunon nëpërmjet ofrimit të informacionit jo të fshehtë dhe publik lidhur me çështjen në fjalë. Pala e adresuar gjithashtu do të ofrojë informata tjera Palës kërkuese, në përputhje me legjislacionin e saj vendor dhe arritjes së marrëveshjes së kënaqshme në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të saj nga Pala kërkuese.

Neni 14 ***Pagesat dhe Transferet***

1. Përveçse në rrethanat e parashikuara në nenin 15, një palë nuk zbaton kufizime në transferet ndërkombëtare dhe pagesat për transaksionet e tanishme me një palë tjetër sa i përket angazhimeve të saja specifike.

2. Nëse një Palë ndërmerr një angazhim për qasje në treg në lidhje me ofrimin e një shërbimi nëpërmjet një mënyre të ofrimit të përmendur në nenin 2 dhe kur lëvizja ndërkufitare e kapitalit është pjesë thelbësore e shërbimit në vetvete, atëherë ajo Palë zotohet për të lejuar lëvizjen e tillë të kapitalit. Nëse një Palë ndërmerr një angazhim për qasje në treg sa i përket ofrimit të një shërbimi nëpërmjet një mënyre të ofrimit të referuar në nenin 2, atëherë e njëjta angazhohet që të lejojë transferet përkatëse të kapitalit në territorin e saj.

3. Asgjë në këtë Protokoll nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar (këtu e tutje referuar si "FMN"), përfshirë përdorimin e veprimeve të shkëmbimit që janë në përputhje me nenet e Marrëveshjes së FMN, me kusht që Palët të mos vendosin kufizime mbi transaksionet kapitale në kundërshtim me angazhimet e saj specifike në lidhje me transaksione të tilla, përveç kur një gjë e tillë bëhet bazuar në nenin 15 ose me kërkesë të FMN-së.

Neni 15 ***Kufizimet për Mbrojtjen e Bilancit të Pagesave***

1. Palët, për të mbrojtur bilancin e pagesave, përpiqen të shmangin vendosjen e kufizimeve në ofrimin e shërbimeve.

2. Çdo kufizim për të mbrojtur bilancin e pagesave të miratuara ose të mbajtura nga një Palë bazuar në dhe në përputhje me nenin XII të GATS (Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime) konsiderohet të jetë në përputhje me këtë Protokoll.

Neni 16

Përfshirjet e Përgjithshme

1. Në varësi të kërkesës që masat e tilla nuk aplikohen në atë mënyrë që do të përbënte diskriminim të pajustificuar ose arbitrar ndërmjet Palëve në rastet kur ekzistojnë kushte të ngjashme ose një kufizim i maskuar mbi tregtinë në shërbime, asgjë në këtë Protokoll nuk interpretohet si parandaluese e miratimit ose zbatimit nga një Palë të masave:

- (a) të domosdoshme për të mbrojtur moralin publik ose për të ruajtur rendin publik;⁶
- (b) të domosdoshme për të mbrojtur jetën ose shëndetin e njeriut, kafshëve ose bimëve;
- (c) të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet ose rregulloret të cilat nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Protokoll, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me:
 - (i) parandalimin e praktikave mashtruese ose trajtimin e efekteve të një vonese në kontratat e shërbimeve;
 - (ii) mbrojtjen e privatësisë së individëve në lidhje me përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të shënimeve dhe llogarive individuale;
 - (iii) sigurinë;
- (d) në kundërshtim me nenin 5, me kusht që dallimi në trajtim synon të sigurojë vendosjen ose mbledhjen e barabartë ose efektive⁷ të taksave të drejtpërdrejta në

⁶ Përfshirja për shkak të rendit publik mund të bëhet vetëm kur kërcënimi i interesave themelore të shoqërisë është i vërtetë dhe mjaft serioz.

⁷ Masat që kanë për qëllim sigurimin e vendosjes ose grumbullimit të barabartë ose efektiv të taksave të drejtpërdrejta përfshijnë masat e marra nga një Palë në sistemin e tij tatimor i cili:

- (i) zbatohet për ofruesit jo-rezidentë të shërbimeve në njohjen e faktit se detyrimi tatimor i jo-rezidentëve përcaktohet sipas artikujve të tatueshëm me burim apo që gjenden në territorin e Palës; ose
- (ii) zbatohet për jo-rezidentët për të siguruar vendosjen ose vjeljen e taksave në territorin e Palës; ose
- (iii) zbatohet për jo-rezidentët ose rezidentët në mënyrë që të parandalohet shmangia ose evazionin i taksave, duke përfshirë masat e pajtueshmërisë; ose
- (iv) zbatohet për konsumatorët e shërbimeve të ofruara në territorin ose nga territori i një Pale tjetër për të siguruar vendosjen ose vjeljen e taksave për konsumatorët e tillë që rrjedhin nga burimet në territorin e Palës; ose
- (v) dallon ofruesit e shërbimeve që i nënshtrohen tatimit mbi artikujt e tatueshëm në mbarë botën nga ofrues të tjerë të shërbimeve, në njohjen e dallimit në natyrën e bazës tatimore mes tyre; ose

lidhje me shërbimet ose ofruesit e shërbimeve të Palëve tjera;

(e) në kundërshtim me nenin 3, me kusht që dallimi në trajtim të jetë rezultat i një marrëveshjeje për shmangien e tatimit të dyfishtë ose dispozitave për shmangien e tatimit të dyfishtë në ndonjë marrëveshje ose aranzhim tjetër ndërkombëtar me të cilën Pala është e lidhur.

Neni 17 ***Përfshirjet e Sigurisë***

1. Asgjë në këtë Protokoll nuk interpretohet si:

- (a) kërkesë nga cilado Palë për dhënien e çfarëdo informacioni, shpalosjen e të cilit e konsideron të jetë në kundërshtim me interesat e saja themelore të sigurisë; ose
- (b) pengesë për Palët në ndërmarrjen e veprimeve që ato i konsiderojnë të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të saja themelore të sigurisë:
 - (i) lidhur me ofrimin e shërbimeve të kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me qëllim të sigurimit të një establishmenti ushtarak;
 - (ii) në lidhje me materialet e zërthyeshme dhe të bashkueshme ose nga materialet të cilat ato rrjedhin;
 - (iii) të marra në kohë lufte ose emergjenca të tjera në marrëdhëniet ndërkombëtare; ose
- (c) pengesë për çdo palë në ndërmarrjen e veprimeve për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga Karta e Kombeve të Bashkuara lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

2. Nën-komiteti për Tregti në Shërbime informohet në masën më të plotë lidhur me masat e marra bazuar në paragrafët 1(b) dhe (c) dhe lidhur me ndërprerjen e tyre.

(vi) përcakton, alokon ose ndanë të ardhurat, fitimin, të hyrat, humbjen, zbritjen ose kredinë e personave ose degëve rezidente, ose ndërmjet personave të lidhur ose degëve të të njëjtit person, me qëllim ruajtjen e bazës tatimore të Palës.

Termat ose konceptet e taksave në kuptim të paragrafit (d) dhe kësaj fusnote përcaktohen sipas përkufizimeve dhe koncepteve të taksave, ose përkufizime dhe koncepteve ekuivalente ose të ngjashme, bazuar në ligjin e brendshëm të Palës që miraton masën.

Neni 18

Bashkëpunimi për Tregtinë Elektronike

1. Palët, duke parë se tregtia elektronike rrit mundësitë e tregtisë në shumë sektorë, bien dakord për të nxitur zhvillimin e tregtisë elektronike midis tyre, në veçanti duke bashkëpunuar në çështjet e ngritura nga tregtia elektronike sipas dispozitave të këtij Protokollit.
2. Palët bien dakord që zhvillimi i tregtisë elektronike duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që të sigurohet besimi i përdoruesve të tregtisë elektronike.
3. Palët bien dakord që dërgesat përmes mjeteve elektronike konsiderohen si ofrim i shërbimeve, brenda kuptimit të nenit 1 (ofrimi ndërkufitar i shërbimeve) dhe nuk i nënshtrohet detyrimeve doganore.
4. Palët mbajnë një dialog mbi çështjet rregullatore të ngritura nga tregtia elektronike, që ndër të tjera, do të adresojë çështjet e mëposhtme:
 - (a) njohjen e certifikatave të nënshkrimeve elektronike të lëshuara për publikun dhe lehtësimin e shërbimeve të certifikimit ndërkufitar;
 - (b) përgjegjësinë e ofruesve të shërbimit ndërmjetës në lidhje me transmetimin, ose ruajtjen e informacionit;
 - (c) trajtimin e komunikimeve jo të kërkuara komerciale elektronike;
 - (d) mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e tregtisë elektronike;
 - (e) çdo çështje tjetër relevante për zhvillimin e tregtisë elektronike.
5. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë formën e shkëmbimit të informacionit mbi legjislacionin përkatës të brendshëm të Palëve për këto çështje, si dhe për zbatimin e legjislacionit të tillë.

Neni 19

Mohimi i Përfitimeve

Një Palë mund t'ia mohojë përfitimet e këtij Protokollit një ofruesit të shërbimit të një Pale tjetër nëse vërteton se shërbimi është duke u ofruar në atë Palë nga një person juridik i cili është në zotërim ose i kontrolluar nga personat e një jo-Palë, që nuk kanë funksione substanciale të biznesit në territorin e cilësdo Palë.

Neni 20

Rishikimi

1. Me qëllim të liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë në shërbimet ndërmjet tyre, në veçanti duke eliminuar në thelb të gjitha diskriminimet midis dhe ndërmjet tyre brenda një periudhe prej pesë vjetësh, Palët do të rishikojnë rregullisht Orarin e tyre të angazhimeve specifike, duke marrë parasysh veçanërisht liberalizimin autonom dhe punën e vazhdueshme nën kujdesin e OBT-së. Rishikimi i parë i tillë do të bëhet jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit.

2. Rishikimi i rregullt i nivelit të liberalizimit sipas paragrafit 1 do të marrë parasysh vlerësimin e shkallës së kufizueshmërisë së masave që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve duke përdorur metodologjitë e vendosura nga Banka Botërore dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Neni 21

Nën-komisioni për Tregti në Shërbim

Nën-komisioni për Tregti në Shërbim i krijuar sipas nenit 41 paragrafi 5 të CEFTA 2006 do të lehtësojë dhe mbikëqyrë zbatimin dhe aplikimin e këtij Protokoll nga Palët.

Neni 22

Sipas nenit 47 paragrafi 1 të CEFTA 2006, ky Protokoll është pjesë integrale e CEFTA 2006.

Neni 23

Shtojcat

Shtojcat në vijim formojnë një pjesë integrale të këtij protokoll:

Shtojca I - Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizikë për qëllime biznesi;

Shtojca II - Parimet rregullatore në lidhje me telekomunikacionin;

Shtojca III - Plani i Konsoliduar i Angazhimeve të Qasjes në Treg në Tregtinë e Shërbimeve të Palëve të CEFTA-s.

Neni 24

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Palëve. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Depozituesi.
2. Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.
3. Për secilën Palë që depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.
4. Një Palë mund ta zbatojë këtë Protokoll përkohësisht, nëse kërkesat e saj ligjore të brendshme lejojnë, derisa ajo Palë të ketë depozituar instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit në përputhje me paragrafin 2. Çdo zbatim i përkohshëm i këtij Protokoll i njoftohet Depozituesit.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të Plotfuqishmit e të gjitha Palëve të CEFTA-s, të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë miratuar këtë Protokoll.

Arritur në Bruksel më [datë], në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila depozitohet pranë Depozituesit të CEFTA-s 2006, i cili do të transmeton kopjet e vërtetuara tek të gjitha Palët e CEFTA-s”.

SHTOJCA I

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizikë për qëllime biznesi

Kjo Shtojcë zbatohet për masat nga Palët lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të personelit kyç, të trajnuarve, shitësve të shërbimeve të biznesit, ofruesve të kontraktuar të shërbimeve, profesionistëve të pavarur, dhe vizitorëve afatshkurtër për qëllime biznesi

Seksioni I

Personeli kyç, të trajnuarit, shitësit e shërbimeve të biznesit, ofruesit e kontraktuar të shërbimeve dhe profesionistët e pavarur

1. Në përputhje me objektivat e këtij Protokoll, Palët angazhohen të lejojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të kategorive të mëposhtme të personave fizikë, nën kushtet e mëposhtme: (a) Personeli kyç; (b) të trajnuarit; (c) shitësit e shërbimeve të biznesit; (d) ofruesit e kontraktuar të shërbimeve; dhe (e) profesionistët e pavarur.
2. Për çdo sektor të liberalizuar në përputhje me nenin 4 të këtij Protokoll dhe që i nënshtrohet ndonjë rezervimi të listuar në Shtojcën III, Palët lejojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të kategorive të mëposhtme të personave fizikë.
3. **“Personeli kyç”** nënkupton personat fizikë të punësuar në një person juridik të një Pale, përveç një organizate jofitimprurëse, të cilët janë përgjegjës për themelimin ose kontrollin e duhur, administrimin dhe funksionimin e një ndërmarrjeje.

Personeli kyç përfshin vizitorët e biznesit përgjegjës për themelimin e një ndërmarrjeje dhe të transferuarit brenda korporatës. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personelit kyç lejohet për një periudhë prej gjashtë muajsh në çdo periudhë 12-mujore për vizitorët e biznesit; dhe tre vjet, në shkallë të parë, për të transferuarit brenda korporatës. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për të transferuarit brenda korporatës zgjatet deri në dy vjet shtesë për një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet.

(a) *“Vizitorët e biznesit”* (VB) nënkupton personat fizikë që punojnë në pozita të larta brenda një personi juridik, të cilët janë përgjegjës për themelimin e një ndërmarrjeje. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim i vendosur brenda Palës pritëse; dhe

(b) *“Të transferuarit brenda korporatës”* (TBK) nënkupton personat fizikë që janë punësuar nga personi juridik i një Pale ose kanë qenë partnerë në të për së paku një vit dhe që përkohësisht janë transferuar në një ndërmarrje (përfshirë vartësit, filialet ose degët) në territorin e një Pale tjetër. Personat fizikë në fjalë i përkasin njërës nga kategoritë e mëposhtme:

- (i) *Menaxherët* janë persona fizikë që punojnë në pozita të larta në kuadër të një personi juridik, duke marrë mbikëqyrje të përgjithshme ose drejtim të biznesit, të cilët kryesisht drejtojnë menaxhimin e ndërmarrjes, duke përfshirë:
 - (a) drejtimin e ndërmarrjes, ose të një departamenti ose nën-divizioneve të tij;
 - (b) mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë mbikëqyrës, profesionalë ose drejtues; dhe
 - (c) autorizimin për të rekrutuar dhe shkarkuar personalisht ose për të rekomanduar rekrutimin, shkarkimin ose veprimet tjera në lidhje me personelin.
- (ii) *Specialistët* janë persona fizikë që punojnë në kuadër të një personi juridik që posedon njohuri të specializuara thelbësore për prodhimin, mjetet kërkimore, teknikat ose menaxhimin e ndërmarrjes. Në vlerësimin e njohurive të tilla, do të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për ndërmarrjen, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloji të punës ose tregtisë që kërkon njohuri specifike teknike, përfshirë anëtarësimin në një profesion të akredituar.

4. **“Të trajnuarit”** nënkupton personat fizikë të cilët janë punësuar nga personi juridik i një Pale për të paktën një vit, të cilët posedojnë diplomë universitare dhe që përkohësisht janë transferuar në një ndërmarrje në territorin e një Pale tjetër, për qëllime të zhvillimit të karrierës ose për t’u trajnuar në teknikat ose metodat e biznesit. Ndërmarrjes pranuese mund t’i kërkohej të paraqesë një program trajnimi që mbulon kohëzgjatjen e qëndrimit për miratim paraprak, duke treguar se qëllimi i qëndrimit është për trajnime që korrespondojnë me nivelin e një diplome universitare.

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm për të trajnuarit lejohet deri në një vit.

5. **“Shitësit e shërbimeve të biznesit”** (ShShB) nënkupton personat fizikë të cilët janë përfaqësues të një ofruesi të shërbimit të një Pale që kërkon hyrje të përkohshme në territorin e një Pale tjetër për qëllim të negocimit të shitjes së shërbimeve ose mallrave ose për lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për atë ofrues të shërbimit. Ata nuk angazhohen në shitjen e drejtpërdrejtë për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim i vendosur brenda Palës pritëse.

Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i shitësve të shërbimeve të biznesit lejohet deri në gjashtë muaj në çdo periudhë 12-mujore.

6. **“Ofruesit e kontraktuar të shërbimeve”** (OKSh) nënkupton personat fizikë të punësuar nga një person juridik i një Pale, e cila nuk ka ndonjë ndërmarrje në territorin e një Pale tjetër dhe që ka lidhur një kontratë *bona fide* për të ofruar shërbime me një konsumator në këtë të fundit, duke kërkuar praninë në baza të përkohshme të punonjësve të saj në atë Palë për të përmbushur kontratën në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Kontrata për shërbime, e referuar në këtë mënyrë, duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat e Palës ku është ekzekutuar kontrata.

Ofruesve të kontraktuar të shërbimeve që u lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në një Palë për të ofruar shërbimet në atë Palë, i nënshtrohen kushteve të specifikuara më poshtë:

- (a) Personat fizikë duhet të angazhohen në ofrimin e një shërbimi në baza të përkohshme si punonjës të një personi juridik, i cili ka marrë një kontratë për shërbime në një Palë tjetër.
- (b) Personat fizikë duhet të kenë së paku dy vjet përvojë pune në sektorin e veçantë të veprimtarisë që është subjekt i kontratës për shërbime.
- (c) Personat fizikë duhet të kenë kualifikime profesionale nëse kjo kërkohet për të ushtruar një veprimtari në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e Palës ku ofrohet shërbimi.
- (d) Personat fizikë nuk marrin shpërblim për ofrimin e shërbimeve, përveç shpërblimit të paguar nga punëdhënësit e tyre gjatë qëndrimit në një Palë tjetër.
- (e) Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizik brenda një Pale tjetër do të jetë për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë-mujore ose për kohëzgjatjen e kontratës për shërbime, cilado që është më pak.
- (f) Numri i personave të mbuluar nga kontrata për shërbime nuk duhet të jetë më i madh se që duhet për të përmbushur kontratën, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat e Palës ku ofrohet shërbimi.

7. **“Profesionistët e pavarur”** (PP) nënkupton personat fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi dhe të regjistruar si të vetëpunësuar në territorin e një Pale, të cilët kanë lidhur një kontratë bona fide për të ofruar shërbime me një konsumator në një Palë tjetër, duke kërkuar praninë e tyre në baza të përkohshme në atë Palë për të përmbushur kontratën për ofrimin e shërbimeve.

Profesionistëve të pavarur që u lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në një Palë për të ofruar shërbime në atë Palë, i nënshtrohen kushteve të specifikuara më poshtë:

- (a) Personat fizikë duhet të angazhohen në ofrimin e një shërbimi në baza të përkohshme si persona të vetëpunësuar të regjistruar në një Palë tjetër dhe duhet të kenë një kontratë për shërbime për një periudhë që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj.
- (b) Personat fizikë duhet të posedojnë, në datën e paraqitjes së kërkesës për hyrjen në një Palë, së paku tre vjet përvojë profesionale në sektorin e veprimtarisë që është objekt i kontratës për shërbime.
- (c) Personat fizikë duhet të posedojnë kualifikime profesionale nëse kjo kërkohet për të ushtruar një veprimtari në përputhje me ligjet, rregulloret ose kërkesat e Palës ku ofrohet shërbimi.
- (d) Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i personave fizik në një Palë do të jetë për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë-mujore ose për kohëzgjatjen e kontratës për shërbime, cilado që është më pak.

8. Një Palë nuk mban ose miraton asnjë kufizim të numrit të përgjithshëm të personave fizikë që një person juridik i një Pale tjetër mund të transferojë si personel kyç ose të trajtuarve

në një sektor të veçantë në formën e kuotave numerike ose të një kërkesë për një test të nevojave ekonomike ose test të tregut të punës ose ndonjë kufizim diskriminues. Një Palë nuk kërkon që një ndërmarrje të caktojë në pozita të larta drejtuese persona fizikë të ndonjë kombësie të veçantë.

Seksioni II

Vizitorët afatshkurtër për qëllime biznesi

1. Palët lehtësojnë, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës, hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në territoret e tyre të vizitorëve afatshkurtër për qëllime biznesi nga çdo Palë tjetër me qëllim kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

- (a) Hulumtim dhe Dizajn: Hulumtues teknik, shkencor dhe statistikor në emër të një personi juridik të vendosur në territorin e një Pale tjetër;
- (b) Hulumtim marketingu: Personel që kryen hulumtime ose analiza, përfshirë hulumtimin e tregut, në emër të një personi juridik të vendosur në territorin e një Pale tjetër;
- (c) Seminare trajnimi: Personel i një personi juridik në një Palë që hyn në territorin e një Pale tjetër për të marrë trajnime mbi teknikat dhe praktikat e punës, të punësuar nga personat juridikë ose organizatat në atë Palë, me kusht që trajnimi i marrë të jetë i kufizuar vetëm në vëzhgim, familjarizim dhe mësim në klasë;
- (d) Ekspozita dhe Panairë të Tregtisë: Personel që merr pjesë në panairë të tregtisë me qëllim të promovimit të personit juridik ose të produkteve ose shërbimeve të tij në një Palë tjetër;
- (e) Shitje: Agjentë dhe përfaqësues të shitjes që marrin porosi ose negociojnë kontrata për mallra për një person juridik të vendosur në territorin e një Pale tjetër, por që nuk dërgojnë mallra;
- (f) Blerje: Blerës që blejnë për një person juridik ose personel drejtues dhe mbikëqyrës të angazhuar në një transaksion tregtar të kryer në territorin e një Pale tjetër.
- (g) Takime dhe konsultime: Persona fizikë që marrin pjesë në takime ose konferenca ose angazhohen në konsultime me bashkëpunëtorët e biznesit.

2. Persona që angazhohen në aktivitetet e renditura në paragrafin 1 mund të ju lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në një Palë si vizitorë afatshkurtër për qëllime biznesi, me kusht që ata: (i) të mos jenë të angazhuar vet në shitjen e mallrave ose shërbimeve të tyre për publikun e gjerë ose në ofrimin e mallrave ose shërbimeve të tyre; (ii) të mos marrin në emër të tyre ndonjë shpërblim nga një burim i vendosur brenda Palës ku ata qëndrojnë përkohësisht; dhe (iii) të mos jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në kornizën e një kontrate të lidhur midis një personi juridik, i cili nuk ka prani komerciale në Palën ku vizitorët afatshkurtër për qëllime biznesi qëndrojnë përkohësisht, dhe një konsumator në atë Palë.

3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm i vizitorëve afatshkurtër për qëllime biznesi në territoret e Palëve, kur lejohet, është për një periudhë deri në gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë-mujore.

SHTOJCA II

Parimet rregullatore në lidhje me telekomunikacionin

Në vijim janë përkufizimet dhe parimet mbi kornizën rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e telekomunikacionit.

Përkufizimet

“Telekomunikacioni” nënkupton transmetimin dhe pranimin e sinjaleve nga çdo mjet elektromagnetik.

“Shërbimi i transportit publik të telekomunikacionit” nënkupton çdo shërbim të transportit të telekomunikacioneve që kërkohet, në mënyrë eksplicite ose në fuqi, nga një Palë për t’iu ofruar publikut në përgjithësi. Shërbimet e tilla mund të përfshijnë, ndër të tjera, telegrafën, telefonin, teleksin dhe transmetimin e të dhënave që zakonisht përfshin transmetimin në kohë reale të informacionit të ofruar nga klienti midis dy ose më shumë pikave pa ndonjë ndryshim në pikat fundore (end-to-end) në formën apo përmbajtjen e informacionit.

“Rrjeti i transportit publik të telekomunikacioneve” nënkupton infrastrukturën publike të telekomunikacionit e cila lejon telekomunikacionin midis dhe ndërmjet pikave të përcaktuara të përfundimit/ndërprerjes së rrjetit.

“Përdorues” nënkupton konsumatorin e shërbimit dhe ofruesin e shërbimit.

“Objektet esenciale” nënkupton objektet e një rrjeti të transportit publik të telekomunikacionit ose shërbimi që:

(a) ofrohet ekskluzivisht ose kryesisht nga një numër i vetëm ose i kufizuar ofruesish; dhe

(b) nuk mund të zëvendësohet ekonomikisht apo teknikisht me qëllim të ofrimit të një shërbimi.

Një “furnizues i madh” nënkupton një furnizues i cili ka aftësinë të ndikoj materialisht në kushtet e pjesëmarrjes (duke pasur parasysh çmimin dhe ofrimin) në tregun përkatës për rrjetet dhe shërbimet e telekomunikacionit si rezultat i: (a) kontrollit mbi objektet esenciale; ose (b) përdorimit të pozitës së tij në treg.

1. Masat mbrojtëse konkurruese

Parandalimi i praktikave anti-konkurruese në telekomunikacion

Masat e përshtatshme do të mbahen ose miratohen me qëllim parandalimin e furnizuesve të cilët, vetëm ose së bashku, janë një furnizues i madh nga angazhimi në ose vazhdimi i praktikave anti-konkurruese. Këto praktika anti-konkurruese duhet të përfshijnë në veçanti:

- (a) angazhimin në ndër-subvencionim anti-konkurrues;
- (b) përdorimin e informacionit të marrë nga konkurrentët me rezultate anti-konkurruese; dhe
- (c) mosvënien në dispozicion të informacioneve teknike për objektet esenciale dhe informacioneve relevante komerciale për ofruesit tjerë të shërbimeve në baza kohore, të cilat informacione janë të nevojshme për ta sa i përket ofrimit të shërbimeve.

2. Ndërlidhja

2.1 Ndërlidhja i referohet lidhjes me ofruesit që ofrojnë rrjete ose shërbime të transportit publik të telekomunikacioneve në mënyrë që të lejojnë përdoruesit e një ofruesi të komunikojnë me përdoruesit e një ofruesi tjetër dhe të kenë qasje në shërbimet e ofruara nga një ofrues tjetër, në rastet ku ndërmerren angazhime specifike.

2.2 Ndërlidhja që duhet siguruar

Ndërlidhja me një ofrues të madh duhet të sigurohet në çdo pikë teknikisht të mundshme në rrjet. Një ndërlidhje e tillë duhet siguruar⁸:

- (a) sipas termave, kushteve, (duke përfshirë standardet dhe specifikimet teknike) dhe normave jo-diskriminuese të një cilësie jo më pak të favorshme se ajo e parashikuar për shërbimet e tyre të ngjashme ose për shërbimet e ngjashme të ofruesve jo të ndërlidhur të shërbimeve ose për filialet e saj ose bashkëpunëtorët tjerë;⁹
- (b) në kohën e duhur, në termat, kushtet (duke përfshirë standardet dhe specifikimet teknike) dhe normat e orientuara drejt koston që janë transparente, të arsyeshme, duke marrë parasysh fizibilitetin ekonomik, dhe mjaft të ndara në mënyrë që ofruesi nuk ka nevojë të paguajë për komponentët e rrjetit ose objektet që nuk kërkojnë që të ofrohet shërbimi; dhe
- (c) sipas kërkesës, në pikat përveç pikave të përfundimit të rrjetit që ofrohen për shumicën e përdoruesve, duke iu nënshtruar pagesave që pasqyrojnë koston e ndërtimit të objekteve të nevojshme shtesë.

2.3 Disponueshmëria publike e procedurave për negociata për ndërlidhje

⁸ Ofruesit e shërbimeve apo rrjeteve që nuk janë përgjithësisht të disponueshëm për publikun, siç janë grupet e mbyllura të përdoruesve, kanë të drejta të garantuara për t'u lidhur me rrjetin e transportit publik të telekomunikacionit ose me shërbime sipas termave, kushteve dhe normave të cilat janë jodiskriminuese, transparente dhe me kosto të orientuar. Këto terma, kushte dhe norma mund të ndryshojnë nga termat, kushtet dhe normat e aplikueshme për ndërlidhjen midis rrjeteve dhe shërbimeve publike të telekomunikacionit.

⁹ Mund të vendosen terma, kushte dhe norma të ndryshme për operatorët në segmente të ndryshme të tregut, në bazë të dispozitave të licencimit jodiskriminues dhe transparent, ku dallimet e tilla mund të justifikohen objektivisht sepse këto shërbime nuk konsiderohen "si shërbime".

Procedurat e zbatueshme për ndërlidhje tek një ofrues i madh do të bëhen të qasshme për publikun.

2.4 Transparenca e marrëveshjeve të ndërlidhjes

Secila palë do të sigurojë që një ofrues i madh vë në dispozicion të publikut marrëveshjet e tij të ndërlidhjes ose një ofertë referimi të ndërlidhjes.

2.5 Ndërlidhja: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Një ofrues i shërbimeve që kërkon ndërlidhje me një ofrues të madh duhet të ketë gjithashtu rekurs, qoftë:

- (a) në çdo kohë; ose
- (b) pas një periudhe të arsyeshme kohore, e cila është bërë publike për një organ të brendshëm të pavarur, i cili mund të jetë një organ rregullator siç referohet në paragrafin 5 më poshtë, për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me termat, kushtet dhe normat e përshtatshme për ndërlidhje brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në masën që këto nuk janë përcaktuar më parë.

3. Shërbimi universal

Çdo Palë ka të drejtë të përcaktoj llojin e detyrimit të shërbimit universal që dëshiron të mbajë. Këto detyrime nuk do të konsiderohen si anti-konkurrese në vetvete, duke e ditur që ato administrohen në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe konkurrese në mënyrë neutrale dhe nuk janë më të rënda sesa të nevojshme për llojin e shërbimit universal të përcaktuar nga Pala.

4. Disponueshmëria publike e kritereve të licencimit

Kur kërkohet licenca, të mëposhtmet bëhen publike:

- (a) të gjitha kriteret e licencimit dhe periudha kohore që normalisht kërkohet për të marrë një vendim në lidhje me një aplikim për licencë; dhe
- (b) termat dhe kushtet e licencave individuale.

Arsyet për refuzimin e një licence duhet t'i njoftohen aplikuesit sipas kërkesës.

5. Rregullatorët e pavarur

Organi rregullator në secilën Palë do të jetë i ndarë nga, dhe jo llogaridhënës për çdo ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve të telekomunikacionit. Vendimet dhe procedurat e përdorura nga rregullatorët duhet të jenë të paanshme në lidhje me të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

6. Alokimi dhe përdorimi i burimeve të pakta

Çdo procedurë për alokimin dhe përdorimin e burimeve të pakta, duke përfshirë frekuencat, numrat dhe të drejtat e rrugës, duhet të kryhet në kohë të duhur, në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Gjendja e tanishme e brezave të alokuar të frekuencave duhet të vihen në dispozicion të publikut, por nuk kërkohet identifikimi i hollësishëm i frekuencave të alokuara për përdorime të veçanta qeveritare.

SHTOJCA III

Plani i Konsoliduar i Angazhimeve të Qasjes në Treg në Tregtinë e Shërbimeve të Palëve të CEFTA-s